

SHOQËRIA AKSIONARE EKONOMIA E UJËRAVE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NËN PRONËSI SHTETËRORE SHKUP

PUBLIKIMI numër 2 për dhënien me qira të hapësirës afariste në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut me anë të ankandit publik në mënyrë elektronike

LËNDA E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lëndë e ankandit publik elektronik është dhënia me qira e hapësirës publike në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtueshmëri me shqyrtimin Tabelar në të cilin janë dhënë të dhëna për numrin e parcelës kadastrale dhe komunës kadastrale ku gjendet hapësira afariste, numri i fletës së pronësisë, sipërfaqja e hapësirës afariste (m²), komuna, adresa ku gjendet hapësira afariste, kati dhe numri i lokalit, çmimi i përgjithshëm fillestar, garancia bankare për seriozitetin e ofertës, afati i dorëzimit të aplikimeve për pjesëmarrje në ankandin publik dhe orën e fillimit të ankandit publik.

Mbi bazë të nenit 4 nga Ligji për shitje dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 13/13, 69/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15, 61/15, 129/15, 6/16, 106/16, 21/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/19), si dhe Vendimi i Bordit të drejtorëve të Shoqërisë Aksionare nr. 0202- 1099 i datës 28.04.2021, lënda e ankandit publik elektronik është hapësira afariste e mëposhtme:

I. KOÇAN

Nr. rend.	Numri i Parcelës Kadastrale Komuna Kadastrale dhe Fleta e Pronësisë	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqja (m ²)	Vlera e përgjithshme e vlerësuar hapësirës afariste (në denarë)	Çmimi fillestar i qirasë mujore (në denarë pa TVSH)	Garancion Bankarë për seriozitetin e ofertës (2%)	Afati për dorëzimin e aplikimit për pjesëmarrje në ankandin publik	Ora e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	8202 Koçan 6	Koçan Diga Gradçe 001 PR 000 002 01 000	70,00 68,00 (138,00 m ²)	2.138.052,00	10.690,00	42.761,00	19 ditë nga publikimi (09.07.2021)	14.07.2021 ora 10:00

E DREJTA PËR PJESËMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kanë:

1. Persona fizikë: shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut, shtetas të shteteve anëtarë të Unionit Europian dhe të OECD, si edhe shtetas të shteteve që nuk janë anëtarë të Unionit Europian dhe të OECD, dhe nën kushte të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtë të marrjes me qira të hapësirës afariste në territorin e Republikën e Maqedonisë së Veriut.

2. Persona juridikë: person juridik vendas, person juridik në pronësi të përzierë, person juridik i themeluar nga person fizik dhe juridik i huaj, të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, persona të huaj juridikë rezidentë të shteteve anëtare të Unionit Europian dhe të OECD, si edhe persona juridikë të huaj rezidentë të shteteve që nuk janë anëtare të Unionit Europian dhe të OECD, dhe që nën kushte të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e përdorimit me qira të hapësirës afariste në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KUSHTE PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

Personat fizikë dhe juridikë të interesuar dorëzojnë aplikim për pjesëmarrje në ankandin publik me anë të rrugës elektronike, për çdo objekt afarist në mënyrë individuale, në të cilin është përmendur për cilën parcelë sillet vetë aplikimi dhe cilat dokumente janë pjesë përbërëse e aplikimit, të kompletuar me këto dëshmi:

1. Aplikim nga dorëzuesi, në të cilin janë përmendur të dhëna për dorëzuesin e aplikimit (emri dhe mbiemri, dmth emri; adresa; numri i telefonit për kontakt);
2. Garancinë Bankare për seriozitetin e ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik në shumën prej 42.761,00 (2% të vlerës së vlerësuar) me afat vlefshmërie prej të paktën 60 ditë nga dita e ankandit publik në të cilin duhet të përmendet adresa se ku gjendet hapësira afariste;
3. Për personat fizikë certifikatë shtetësie, origjinale ose kopje të vërtetuar në noter, jo më të vjetër se 6 muaj;
4. Për personat juridikë dëshmi për regjistrimin e personit juridik të lëshuar nga regjistri përkatës, origjinale ose kopje të vërtetuar në noter, jo më të vjetër se 6 muaj;
5. Adresa e-mail për dorëzuesin e aplikimit, nëpërmjet të cilës do të kryhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, domethënë do t'i dorëzohen emri i përdoruesit dhe shifra për qasje në faqen e internetit në të cilën do të zhvillohet ankandi publik elektronik **(për dorëzuesit e aplikimeve që do të dorëzojnë adresë të gabuar e-mail, SHA Ekonomia e Ujërave - Shkup nuk ka obligim që të pranojë dhe të bëjë korrigjime në të njëjtën);**
6. Shpenzimet për sigurimin dhe dorëzimin dokumenteve të nevojshme për regjistrimin dhe pjesëmarrjen në procedurën e ankandit publik elektronik janë në ngarkesë të dorëzuesit të aplikimit.

Aplikimet që nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik, për çka dorëzuesit e aplikimeve jo komplete do të njoftohen me anë të rrugës elektronike.

AFATE

Aplikimet për pjesëmarrje në ankandin publik duhet të dorëzohen jo më vonë se **19 ditë** nga dita e publikimit **(deri në datën 09.07.2021 deri në orën 23:59)**, me anë të rrugës elektronike në faqen e internetit: **www.deloven-prostor.mk**.

Garancion Bankarë (origjinal) dhe Çertifikata e shtetësisë për person fizik (origjinale ose kopje të verifikuar në noter) ose Dëshminë për regjistrim të personit juridik (origjinale ose kopje të verifikuar në noter) duhet të dorëzohen edhe tek Shoqëria aksionare Ekonomia e Ujërave e Republikës së Maqedonisë së Veriut nën pronësi shtetërore, Shkup, në rr. Brigada e 3-të Maqedonase nr. 10a, jo më vonë se dita e fundit për dorëzim të aplikimit 09.07.2021 deri në orën 15:00.

Ankandi publik do të mbahet me anë të rrugës elektronike në këtë faqe interneti: **www.deloven-prostor.mk**.

Ankandi publik do të fillojë në termin e përmendur në shqyrtimin tabelar, për çdo objekt afarist në mënyrë individuale.

PROCEDURA

1. Pas pranimit të aplikimit (dokumentacionit të nevojshëm), Komisioni e konfirmon kompletimin e tyre në pajtueshmëri me kushtet e njoftimit, me çka i njofton dorëzuesit e aplikimeve me anë të rrugës elektronike.
2. Dorëzuesve të aplikimeve që janë kompletë, Komisioni në afat prej 3 ditësh nga dita e dorëzimit të aplikimit u dorëzon emër përdoruesi dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, dhe dorëzuesve të aplikimeve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion komplet u dorëzon njoftim me arsyetimin se nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.
3. Dorëzuesit e aplikimeve që kanë dorëzuar aplikime komplete për pjesëmarrje në ankandin publik në pajtueshmëri me njoftimin, në ditën e zbatimit të ankandit publik regjistrohen në faqen e internetit të cekur në njoftimin me emrin e përdoruesit dhe shifrën për pjesëmarrje në ankandin publik, me çka kanë të drejtë për të marrë pjesë në ankandin publik.
4. Ankandi publik do të mbahet nëse pjesëmarrësit i plotësojnë kushtet e dhëna në njoftim.

5. Ankandi publik do të mbahet edhe nëse pas njoftimit është regjistruar vetëm një pjesëmarrës që i plotëson kushtet e dhëna në njoftim.
6. Ankandi publik fillon me njoftimin e çmimit të përgjithshëm fillestar për qiranë mujore të hapësirës afariste dhe zbatohet me anë të ankandit nga ana e pjesëmarrësve. Në pesë minuat e para të ankandit publik pjesëmarrësit mund ta pranojnë, domethënë ta zmadhojnë çmimin e qirasë. Ankandi publik konsiderohet si i përfunduar në momentin e skadimit të kohës së përcaktuar të përcaktuar në njoftim, ku nëse gjatë kalimit të dy minutave të fundit nga koha e përcaktuar për kohëzgjatjen e ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është dhënë ofertë, afati përfundimtar për përfundim të ankandit publik zgjatet për dy minuta të tjera, dhe do të përfundojë kur në periudhën për dy minutat e tjera nuk ka ofertë të re.
7. Ankandi publik vazhdon në mënyrë të pakufizuar derisa në intervalin kohor prej dy minutash ka ofertë të re. Nëse në pesë minutat e para të ankandit publik nuk është pranuar oferta, domethënë nuk është dhënë ofertë më e lartë, çmimi i përgjithshëm fillestar për qiranë mujore të hapësirës afariste zvogëlohet për 2% ku pjesëmarrësit e ankandit publik do të kenë përsëri mundësinë që ta pranojnë ose zmadhojnë çmimin për qiranë mujore të hapësirës publike.
8. Nëse gjatë kalimit të dy minutave të fundit nga pesë minutat e dyta të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është pranuar oferta, domethënë është dhënë ofertë më e lartë, afati përfundimtar për kryerjen e ankandit publik zgjatet për edhe dy minuta, dhe do të përfundojë kur për periudhën e dy minutave të ardhshme nuk ka ofertë të dhënë të re.
9. Nëse gjatë kohëzgjatjes së pesë minutave përsëri nuk ka ofertë, vlera për qiranë mujore të hapësirës afariste përsëri zvogëlohet për 2% nga çmimi i përgjithshëm fillestar për qiranë mujore të hapësirës afariste. Zvogëlimi i çmimit të përgjithshëm fillestar gjatë ankandit mund të jetë të shumtën deri në 30% se qiraja fillestare mujore për hapësirën afariste, pa dallim se sa ofrues janë regjistruar në ankandin publik.
10. Pas përfundimit të ankandit publik, sistemi elektronik gjeneron (përgatit) vetë procesverbal për ankandin e kryer publik që dorëzohet tek të gjithë pjesëmarrësit në ankandin publik, me anë të rrugës elektronike.
11. Pjesëmarrësit në ankandin publik kanë të drejtë për ankesë vetëm mbi bazë të procedurës së ankandit publik, në afat prej 3 (tre) ditë nga dita e mbajtjes së ankandit publik tek Komisioni, që vendos sipas ankesës me Vendim në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e pranimit të ankesës.
12. Si ofrues më i përshtatshëm konsiderohet pjesëmarrësi i ankandit publik që ka ofruar çmimin e fundit më të lartë, që paraqet çmimin më të lartë për qiranë mujore të hapësirës afariste.
13. Ofruesi më i përshtatshëm është i obliguar që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për zgjedhje të paguajë depozitë (mjete monetare) për sigurimin e obligimeve të Kontratës për qira, në shumën prej 3 (tre) qira mujore në pajtueshmëri me çmimin e arritur të fundit të ankandit dhe tek Komisioni të dorëzojë dëshmi për pagesën e kryer, si dhe dokumentacione për dëshmin e aftësisë të dhëna nga Regjistri Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj. Nëse ofruesi më i përshtatshëm nuk paguan këto mjete monetare në afatin e cekur ose use nuk do të dorëzojë dokumentacionet e nevojshme të aftësisë, nuk do të qaset drejt lidhjes së Kontratës, garancionin bankar do të aktivizohet dhe ofruesit do t'i shprehet ndalim për pjesëmarrëse në procedurat për ankand publik për marrjen ose dhënien me qira të hapësirave afariste në periudhë prej një viti nga dita e shqipëtimin të ndalesës.
14. Shoqëria Aksionare në afat prej 5 (pesë) ditë pas pagesës së kryer të depozitës duhet të lidhë kontratë për qira të hapësirës afariste me ofruesin më të përshtatshëm.
15. Tatimi mbi vlerën e shtuar për shumën e qirasë mujore është në ngarkesë së ofruesit më të përshtatshëm.
16. Kontrata për qira të hapësirës afariste lidhet në kohë të caktuar prej 5 (pesë) vjet, në gjendje të parë, me mundësi për zgjatje dhe solemnizohet tek Noteri në shpenzim të ofruesit më të përshtatshëm dhe e njëjta do të ketë vetinë e dokumentit ekzekutiv.
17. Nëse ofruesi më i përshtatshëm e ndërpret Kontratën për qira në periudhën prej 5 (pesë) vjet të përmendur në Pikën 16, depozita e paguar (mjetet monetare) nuk do të kthehen, përveç në rastet nëse përfundon së ekzistuari si person juridik.
18. Ofruesi më i përshtatshëm nuk duhet ta ri-japë hapësirën afariste me nën-qira dhe duhet ta përdorë vetëm për nevojat e tij.

19. Qiraja mujore paguhet paraprakisht, jo më vonë se ditën e pestë të muajit, pa dallim të pranimi të faturës, dhe pagesën e qirasë jo në kohë llogaritet interes-vonesë ligjore.
20. Garancioni bankarë për seriozitetin e ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet dorëzuesit të aplikimit në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e mbajtjes së ankandit publik, dhe garancia bankare e ofruesit më të përshtatshëm i kthehet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pagesës së depozitës.

Ky njoftim do të jetë i publikuar edhe në WEB faqen të Shoqërisë Aksionare Ekonomia e Ujërave e Republikës së Maqedonisë së Veriut nën pronësi shtetërore, Shkup: <http://www.vodostopanstvo.mk>.

Nr i telefonit për kontakt: +389 02 5116 401

Shoqëria aksionare Ekonomia e Ujërave
e Republikës së Maqedonisë së Veriut
nën pronësi shtetërore, Shkup